

FJALA E DEPUTETIT VANGJEL DULE

E ENJTE 15 SHTATOR 2022

E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur bashkëqytetarë,

Vijmë në këtë moment, në momentin fillestar të procesit të negocimit me Bashkimit European, për të diskutuar instrumentin financiar të paraantarsimit, një proces që vjen të paktën me 8 vjet vonesë. Pra, janë 8 vjet vonesë që kanë një emër dhe mbiemër, për të mos e personalizuar sërish, kanë emrin e qeverisë socialiste të kryesuar nga Edi Rama. Përgjegjësia është e të gjithëve ne, por në veçanti juaja, kolegë, sepse keni edhe ju emrin tuaj në këtë vonesë. Prosesi nuk është më i njëjtë, nuk është më ai që njihnim dhe askush nuk flet këtu, sepse procesi i tanishëm është reversible, i kthyeshëm.

Prej një viti, apo pa u mbushur ende viti, ky proces është i kthyeshëm dhe ne nuk kemi më hapësira tolerance. Ndaj, ne duhet të jemi të përqendruar, të përkushtuar, eficientë në këtë proces. Nuk ka vend për demagogji; nuk ka vend për spekulime; nuk ka vend më për dështime, por, që të mos ketë më vend për këto fenomene, duhet një ndjesë e madhe për këtë vonesë, e cila nuk u dëgjua. Pra, duhet të dëgjohet një ndjesë dhe të shoqërohet me një reflektim. Këtu nuk bëhet fjalë për disa procese, të cilat do të prekin jetën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe çdo aspekt tjetër për 5 apo për 50 vjet, por këtu bëhet fjalë për fatin e vendit në vazhdimësi dhe duhet të jemi të sinqertë, në radhë të parë, me veten tonë dhe pastaj me Bashkimin European.

Ne duhet të jemi pjesëtarë të përhershëm të asaj familjeje, siç na takon, por që e kemi neglizhuar për shkak të interesave të përfaqësuar nga qeveria e sotme dhe nga ato të kaluarat. Nuk do të gjeja termin “integrimin” si më të përshtatshmin, por duhet termi “europianizim” në çdo aspekt, në mentalitet, në gjuhë, qoftë edhe në posturë. E dëgjuat ju Kryeministrin e një

vendi, që sapo çeli negocimin me Bashkimin European, të thotë nga Beogradi, i entuziazmuar nga avujt e verërave të ekspozitës, se politika e ndjekur me vaksinat ishte turp për Bashkimin European? Pse e bëri këtë? Sepse, po të bësh një bilanc të kontributit të Bashkimit European në lidhje me vaksinat, është dominues në favor të Bashkimit European kundrejt çdo pale tjetër që na ka ndihmuar me vaksina. Këtë e bëri për të justifikuar strabizmin e tij gjeopolitik.

Ne nuk kemi vetëm një politikë të jashtme që improvizohet dita-ditës, ora-orës, por në thelb të saj ka strabizimin gjeopolitik, Bashkimin European, por ne si shpëtimtarë në momente të vështira na gjendet edhe Kina, na gjendet edhe Rusia, na gjendet edhe Turqia. Jo, zotërinj! Sado të gatshëm që të jenë në momente vështirësish dhe emergjencash për të përfituar gjeopolitikisht, në asnjë rast ne nuk duhet të kemi as tundimin më të vogël ndaj asnjërit prej tyre. Orientimi ynë është një dhe i vetëm, është i domosdoshëm dhe i detyrueshëm pa alternativë: Bashkimi European dhe vetëm Bashkimi European. Prandaj, gjuha, mentaliteti, sjellja prej një kapadaiu neofeudal dhe politika të tilla nuk kanë vend në Shqipërinë që nis tani, në Shqipërisë e së ardhmes, në Shqipërinë europiane.

Më lejoni t'u referohem edhe dy-tri aspekteve të tjera. Flasim, midis të tjerash, për infrastrukturë, por vendi i vetëm, që ne kemi kufij tokësorë me Bashkimin European është Greqia. Kemi 6 pika kalimi kufijtë, dy prej të cilave, ajo e Dhrimadhes-Sopiki dhe Ripesi-Ampelones, nuk kanë rrugë automobilistike dhe me të gjitha fondet e administruara gjatë gjithë këtyre viteve nuk kemi ende akses rrugor që të qarkullojnë njerëzit. I shikoni vështirësitë që kemi gjatë muajve të verës në qarkullimin ndërmjet dy vendeve. Ndërsa nga pala greke ka rrugë të shtruara me asfalt deri në këto pika, ne nuk kemi. Në periudhën e dimrit nuk ka rrugë ku mund të kalojnë mjetet bujqësore, zëtorët apo traktorët, merrini me mend makinat e ulëta!

Ne pretendojmë se duam lidhje intensive dhe shkëmbime midis njerëzve, ekonomive, kulturave dhe jo pa qëllim janë këto neglizhenca. Shikoni komunën e Pogonit; shikoni komunën e Zagorisë; shikoni komunën e Dhivrit, zonën e Thellogos, a ka në të gjithë Republikën e Shqipërisë qendra, ish-njësi administrative, bashki apo komuna, që nuk kanë rrugë të asfaltuara për në qendrat e ish-komunave?! Më thoni, kolegë, nëse në zonat tuaja keni qendra, ishkomuna, që nuk kanë rrugë asfalti. Këto bëhen me qëllim. Këtu ka tendencë, këtu ka

prapamendim. Këto janë zona me histori, me trashëgimi, me vlera, me potenciale ekonomike, me zhvillime turistike dhe me agroturizëm, por që janë më të braktisurat.

Po kaloj në një pikë tjetër. Flasin se do të bëhemi si europianët. Përfitoj nga rasti, nga prania e ministres së Financave këtu, ta shtroj pyetjen për të tretën herë radhazi: a doni të sillemi si europianë? Von der Leyen pardje komunikoi me të gjitha tonet në mbarë botën, që një nga masat imediate, e cila sugjerohet të ndërmerret nga të gjitha qeveritë e BE-së, është tatimi i jashtëzakonshëm për përfitimet e jashtëzakonshme të kompanive gjatë periudhës së krizës. Zonja Ibrahimaj, zonja Ministre, a ka menduar, a ka diskutuar, a ka ndërmend qeveria e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Financave, që ju drejtoni, të trajtojë çështjen e fitimeve të jashtëzakonshme të kompanive të caktuara? Nëse po, nëse jo, na jepni një përgjigje kur mund ta kemi atë. Kjo është të veprosh si europian.

Nuk mund të pretendosh të sillesh si europian dhe, nga ana tjetër, të ushtrosh politika klienteliste, që nuk kanë asgjë me shtetin e së drejtës, me një demokraci funksionale, me një sistem kapitalist, por në të njëjtën kohë që ndjek edhe politika shoqërore e sociale. Po e mbyll me një xhevahir të kësaj qeverie, që detyrohem ta përmend për së dyti. Javën e kaluar Kryeministri zgjoi dynjanë duke thënë se në Zvicër burgosin njerëz nëse termostatin do ta vendosin mbi 19 gradë. Mendova të shihja se çfarë po ndodhte në Zvicrën tonë të dashur! Ndërkohë, pashë se ishte një artikull gazete, e cila shtronte se një ndër masat potenciale që mund të merren “nëse, nëse, nëse...” mund të ishte edhe kjo.

Kryeministri e bëri fakt për Zvicrën. Ai në mentalitet e ka të rrënjosur burgun për kundërshtarin, burgun për qytetarin, ai ka çuar në burg me dhjetëra e me qindra qytetarë për mospagesën e faturave të ujit të dritave, apo siç është rasti i arrestimit të zonjës së moshuar në Vlorë, e cila ngriti kotecin e pulave. Merreni me mend! Sot lexoj një artikull, ku ministrja e Energjetikës, zëvendëskryeministrja, u thoshte nxënësve të shkollës se në Zvicër të fusin në burg nëse termostatin e vendosin mbi 19 gradë. “O tempora, o mores!”. Si ka mundësi t’u flasë nxënësve të shkollës për burg dhe për pranga zëvendëskryeministrja?! Bëra përsëri një kërkim dhe “Swissinfo” kishte bërë një fact check, siç thuhet në gjuhën moderne në medie dhe, pasi analizonte çdo gjë që ishte thënë, thoshte fake, sepse është fake news.

Pra kemi një propagandë qeveritare që mbështetet mbi fake news, sepse kemi një qeveri fake, një Kryeministër fake dhe ministra fake. Ky është realiteti në vendin tonë. Nëse doni, pranojeni; nëse nuk doni, mos e pranoni.